Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/08
Datë: 28.10.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 tetor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen Ekstrakti i Procesverbalit dhe Transkripti i mbledhjes së shtatë (7) të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/08
Datë: 28.10.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 tetor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Suedisë, për Ekstradim.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/08
Datë: 28.10.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 tetor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Suedisë, për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/08
Datë: 28.10.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 tetor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Suedisë, për Transferimin e Personave të Dënuar.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/08
Datë: 28.10.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 tetor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ratifikimin e Traktatit për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështje Penale, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Belgjikës.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/08
Datë: 28.10.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 43 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 tetor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti për Vlerësimin Ex-Post të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës.

2. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit që, në bazë të gjetjeve dhe rekomandimeve të Raportit të përcaktuar në pikën 1. të këtij Vendimi, në bashkëpunim me ministritë përkatëse, ta përditësojë Programin e Projektligjeve.

3. Raporti i Vlerësimit Ex-Post të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

4. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Programin e Projektligjeve, të përditësuar sipas pikës 2. të këtij Vendimi, t'ia përcjellë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/08
Datë: 28.10.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 42, paragrafi 2, dhe nenit 43 të Ligjit Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 tetor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës ia propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës për emërim anëtarët e Këshillit Kombëtar të Shkencës, në këtë përbërje:

   1.1. Aliriza Arënliu, Psikologji;
   1.2. Arbnora Dushi, Folkloristikë;
   1.3. Armond Daci, Farmakologji;
   1.4. Arven Syla, Energjetikë;
   1.5. Besnik Krasniqi, Ekonomi dhe Ndërmarrësi;
   1.6. Emine Kalaja - Hajdari, Histori;
   1.7. Fetah Podvorica, Elektrokimi;
   1.8. Ibrahim Krasniqi, Ekonomi dhe Menaxhim;
   1.9. Majlinda Bregasi, Gjuhësi;
   1.10. Mentor Alishani, Veterinari;
   1.11. Mihone Kerolli - Mustafa, Inxhinieri Mjedisore;
   1.12. Mimoza Ibrani, Telekomunikacion;
   1.13. Myzafere Krasniqi - Limani, Elektronikë;
   1.14. Tringa Dedi, Pedagogji;
   1.15. Valmir Krasniqi, Matematikë.

2. Anëtarët e propozuar të Këshillit Kombëtar të Shkencës emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore.

3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin bashkë me dokumentacionin përkatës t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/08
Datë: 28.10.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 25 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 tetor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti vjetor për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë, për vitin 2025.

2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij Vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/08
Datë: 28.10.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 11, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 tetor 2026, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik të pronave të paluajtshme, strukturave (objekteve të banimit, objekteve përcjellëse dhe ekonomike), kulturave bujqësore dhe investimeve të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i Rrugës Korishë – Kabash - Lidhja me Rrugën Rajonale R-118", zonat kadastrale: Lubizhdë, Skorobishtë, Korishë dhe Kabash, Komuna e Prizrenit, sipas tabelave të bashkëngjitur këtij Vendimi.

2. Pjesë integrale e këtij Vendimi janë raportet e vlerësimit të punuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat të bashkëngjitura këtij Vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit.

3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit ia dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.

4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente, vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Mjetet buxhetore për pagesën e pronave të shpronësuara do të sigurohen nga subjekti kërkues - Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, në pajtim me dokumentin: Qarkorja buxhetore 2027/01, protokoll nr. 987/2026, të datës 15 maj 2026, nga Ministra e Financave, pika 4 –Kriteret e përgjithshme për përgatitjen e buxhetit për 2027-2029, çështja 6 - Buxhetimi i projekteve kapitale duhet të përfshijë edhe shpenzimet e shpronësimit si pjesë e kostos totale të projektit. Nuk lejohet planifikimi i linjave të veçanta buxhetore për shpronësim.

8. Shuma e kompensimit për shpronësimin e përcaktuar në Vendimin Përfundimtar paguhet plotësisht brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit.

9. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratit të shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastralë në emër të titullarëve të rinj, si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Drejtoria për Kadastër e Komunës përkatëse është e obliguar t'i kryejë veprimet procedurale për zbatimin e tij.

10. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/08
Datë: 28.10.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 9, 10, dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 tetor 2026, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i projektit: "Ndërtimi i Rrugës Tranzit në Klinë, nga N9 deri në R-104 Klinë – Gurakoc", zona kadastrale Klinë, Klinafc, Dollc dhe Dresnik Komuna e Klinës, sipas tabelave bashkëngjitur këtij Vendimi.

2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit brenda pesë (5) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit, të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

3. Kundër këtij Vendimi apo cilësdo pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, subjekti kërkues dhe cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor), Departamenti i Infrastrukturës Rrugore (Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit) dhe Ministria e Financave.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/08
Datë: 28.10.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 7, 8 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 tetor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejmë i Kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i projektit: "Ndërtimi i Autostradës Prishtinë – Gjilan - Dheu i Bardhë, Segmenti Banullë – Bresalc", zonat kadastrale Smallushë dhe Sllovi, Komuna e Lipjanit, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.

2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".

3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, në pajtim me nenin 8, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

4. Mjetet buxhetore për pagesën e pronave të shpronësuara do të sigurohen nga subjekti kërkues - Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, në pajtim me dokumentin: Qarkorja buxhetore 2027/01, protokoll Nr. 987/2026, e datës 15 maj 2026, nga Ministra e Financave, pika 4 – Kriteret e përgjithshme për përgatitjen e buxhetit për vitet 2027-2029, çështja 6 - Buxhetimi i projekteve kapitale duhet të përfshijë edhe shpenzimet e shpronësimit si pjesë e kostos totale të projektit. Nuk lejohet planifikimi i linjave të veçanta buxhetore për shpronësim.

5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor), Departamenti për Infrastrukturë Rrugore (Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit) dhe Ministria e Financave.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/08
Datë: 28.10.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 24, paragrafët 1 dhe 4, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 tetor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Komunës së Prizrenit për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumë prej 1,489,670.00€ (një milion e katërqindetetëdhjetenëntë mijë e gjashtëqindeshtatëdhjetë euro), për realizimin e projektit "Efiçienca e Energjisë në Ndërtesa Publike në Prizren", përmes Klauzolës së Investimeve (fondi burimor 06), me qëllim të përmbushjes së obligimeve financiare që rrjedhin nga punët e realizuara, në përputhje me dinamikën e zbatimit të projektit.

2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, me kod 201, nga nënprogrami "Huamarrja për projekte potenciale brenda MFPT", me kod 48900, nga kategoria e shpenzimeve "Investime Kapitale", nga projekti "Kontingjenca për Klauzolë të Investimeve", me kod 15045, nga fondi burimor 06, dhe transferohen në Komunën e Prizrenit, me kod 622, në nënprogramin "Buxhetimi", me kod 17510, në kategorinë e shpenzimeve "Investime Kapitale", në projektin "Efiçienca e Energjisë në Ndërtesa Publike në Prizren", me kod 53715, përmes Klauzolës së Investimeve (fondi burimor 06).

3. Obligohen Ministria e Financave dhe Komuna e Prizrenit për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.